



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 9 , datë 05. 04. 2012

**PËR
“VENDOSJEN E MEMORIALIT NË KUJTIM TË HOLOKAUSTIT”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen e pllakës memoriale në kujtim të Holokaustit, në “Shëtitoren e Parkut të Madh” nga ana e sheshit “Frederik Shopen”, si dhe në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); neneve 7 dhe 32 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendosjen e memorialit në kujtim të Holokaustit, në “Shëtitoren e Parkut të Madh” nga ana e sheshit “Frederik Shopen”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI

